



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 193, Datë 02.12.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME, NGA DIELLI ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 2 MW DHE ERA ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 3 MW, PËR VITIN 2019.

Në mbështetje të nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” dhe “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 02.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 113/3 Prot, datë 26.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW, për vitin 2019,

Konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.
- VKM nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.
- ERE, me anë të Vendimit nr. 205, datë 13.09.2018 vendosi “Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri 3 MW per vitin 2018” dhe gjatë kësaj periudhe ka kryer analizat e saj në mbështetje të të dhënave dhe planeve të biznesit të shoqërive të licencuara të cilat kanë qënë subjekt i vendimmarrjes për çmimin e vitit 2017, të dhënave të marra gjatë monitorimit të kryer në zbatim të Urdhërit nr. 71, dt. 24.01.2019, të kryetarit të ERE-s, si dhe të dhënat e planeve të bizneseve të të licencuarve që tashmë kanë marrë autorizimin dhe kanë lidhur kontratë me MIE-n të cilët do të jenë subjekt i vendimmarrjes së ERE-s për vitin 2018
- Gjithashtu është administruar dokumentacioni i paraqitur nga subjektet që kanë lidhur kontratë me Ministrinë e Infratrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e centraleve eolike.

- Nga shoqëria "Max Energy", sh.p.k, me anë të shkresës nr.31 prot, datë 06.11.2019 është kërkuar miratimi i çmimit të shitjes së energjisë nga Impianti Eolik Topojë, Fier.
- Nga shoqëria "Windsbab" sh.p.k me anë të shkresës nr.18 prot, datë 12.11.2019 është kërkuar miratimi i çmimit të shitjes së energjisë nga Impianti Eolik Topojë, Fier.
- Nga shoqëria "Seman Eolik" shpk me anë të shkresës nr.02 prot, datë 12.11.2019 është kërkuar miratimi i çmimit të shitjes së energjisë nga Impianti Eolik Topojë, Fier,
- VKM nr. 369, datë 26.04.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga kjo kategori prodhuesish e jo çmim individual për çdo aplikues që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë VKM.
- MIE me shkresës protokolluar në ERE me nr. 690 Prot, datë 01.11.2019, shprehet se ka lëshuar Miratimin për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike lundruese dhe veprave ndihmëse mbi rezervuarin e HEC Banjë, Bashkia Cërrik, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe duhet të vijojë me nënshkrimin e kontratës për këtë projekt, duke kërkuar nga ERE parashikimin dhe përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike lundruese, duke sugjeruar që, për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike lundruese, të merret në konsideratë Metodologjia e vlerësimit të kostove të energjisë nga burime të rinovueshme e cila mbështetet tek e njëjta formulë e LCOE, sipas VKM 369, datë 26.04.2017 Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era".

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli (centralet fotovoltaike) me fuqi të instaluar deri në 2 MW dhe nga era (centralet eolike) me fuqi të instaluar deri në 3 MW, për vitin 2019.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI